

UDHËZIME PËR OFRUESIT E KUJDESIT SHËNDETËSOR

si reagim ndaj rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

Profesionistët e kujdesit shëndetësor janë shpesh të parët që zbulojnë nëse gratë kanë përjetuar dhunë nga burrat, prandaj është e rëndësishme që mjekët dhe infermieret të sigurohen që kjo të mos jetë një **mundësi e humbur për t'i referuar pacientët në organizatat lokale të grave** që mbështesin të mbijetuarat e dhunës!

Përmbajtja e këtij udhëzuesi bazohet në vlerësimin rajonal "Bashkëpunimi ndërmjet OJQ-ve të grave dhe ofruesve të kujdesit shëndetësor: Një studim krahasues në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi" si pjesë e programit rajonal të UN Women për ti dhënë fund dhunës ndaj grave, "Zbatojmë Normat, Ndryshojmë Mendësitë".

Një në tre gra do të përjetojnë dhunë fizike ose seksuale në një moment të jetës së tyre, që është mbi **700 milionë gra** në mbarë botën.¹

Nga **1 në 5 gra** e tregojnë për herë të parë dhunën në familje te mjeku i tyre i përgjithshëm.²

Ekzistojnë **forma të ndryshme të dhunës ndaj grave** që shkojnë përtej dhunës fizike, si dhuna psikologjike, seksuale dhe financiare.

?! Kuptimi i dhunës ndaj grave

Dhuna në familje zakonisht përfshin **sjellje frikësuese dhe kontrolluese**, përmes të cilave dhunuesi kontrollon partneren e tij duke përdorur sulmin, kërcënimin, poshtërimin dhe frikësimin.

Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje mund të prekë të gjitha gratë pavarësisht nga mosha, raca, besimet fetare, statusi social dhe orientimi seksual.



Pandemia e COVID-19 ka rritur më tej ekspozimin e grave ndaj dhunës, si rezultat i masave të tilla si izolimet që kanë lënë shumë gra të mbijetuara të bllokuara me autorët e tyre.

Treguesit fizikë të dhunës përfshijnë: mavijosje të pashpjegueshme dhe lëndime të tjera, aborte spontane dhe komplikime të tjera të shtatzënisë, gjendje kronike duke përfshirë dhimbje koke, dhimbje muskujsh, infeksione seksualisht të transmetueshme dhe probleme të tjera gjinekologjike.

Treguesit psikologjikë të dhunës përfshijnë: shqetësimin emocional, çrregullimet e gjumit dhe të të ngrënit, vetëlëndimin ose tentativat për vetëvrasje, abuzimin me alkoolin ose drogën.

Reagimi ndaj zbulimit të dhunës në familje



- ➔ Nëse keni shqetësime se pacientja juaj po përjeton dhunë në familje, ju duhet të kërkonti të flisni **vetëm me të**, të ndarë nga partneri i saj ose ndonjë anëtar tjetër i familjes.
- **Dëgjojeni në mënyrë aktive** të mbijetuarën dhe mos u përpiqni ta bindni atë të largohet nga dhunuesi, të mbijetuarat duhet ta vendosin vetë kohën se kur janë gati të largohen.
- Ju gjithmonë mund të bëni **pyetje të gjera** për shëndetin dhe mirëqenien e pacientes tuaj (p.sh. 'Si janë gjërat në shtëpi?').
- Nëse është e përshtatshme, mund të bëni **pyetje të drejtpërdrejta** për çdo dhunë që ato mund të kenë përjetuar (p.sh. "A ka qenë partneri juaj i dhunshëm fizikisht?").
- Nëse shihni lëndime fizike, mund të bëni **pyetje specifike** në lidhje me to (p.sh. mavijosje).
- Nëse qendra shëndetësore juaj ofron konsultime telefonike dhe video në vend të konsultimeve ballë për ballë për shkak të pandemisë COVID-19, pyeteni pacienten nëse është një **moment i sigurt për të folur** (pasi autori mund të jetë në të njëjtën dhomë).

Kryerja e një vlerësimi fillestar të rrezikut



- ➔ Vlerësimi fillestar i rrezikut përfshin të **kuptuarit e situatës imediate** të pacientes dhe rrezikut për sigurinë e saj, për të përcaktuar nëse dhe me kë duhet të vihet në kontakt.
- **Merrni shënime të hollësishme** për situatën aktuale të pacientes dhe perceptimin e saj për rrezikun ndaj sigurisë së saj (kjo do të jetë e rëndësishme nëse një referim konsiderohet i nevojshëm në një fazë të mëvonshme).
- **Dokumentoni të gjitha lëndimet** e pacientes, duke përdorur një formular të standardizuar/kartelë/raport mjekësor edhe nëse ajo nuk dëshiron të kontaktojë menjëherë policinë, kjo në rast se nevojiten prova në një fazë të mëvonshme të procesit gjyqësor (ky dokument duhet të jepet pa pagesë).
- **Të keni njohuri mbi shërbimet e duhura të referimit** dhe të keni informacion në dispozicion që pacientja ta marrë me vete nëse është e nevojshme.
- Nëse keni kohë të kufizuar me pacienten, sigurohuni që të shënoni dëmtimet dhe rreziqet më të rëndësishme për sigurinë e saj dhe kudo që të jetë e mundur, **caktoni një takim pasues**.

1 <https://www.who.int/news/item/09-03-2021-devastatingly-pervasive-1-in-3-women-globally-experience-violence>
2 <https://www.wisnsw.org.au/wp-content/uploads/GP-tool-kit-updated-Oct2019.pdf>


UDHËZIME PËR OFRUESIT E KUJDESIT SHËNDETËSOR

si reagim ndaj rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

Referimi i pacientëve në shërbimet e specializuara mbështetëse

Nëse keni një **SPECIALIST TË BRENDSHËM**

në klinikë, i cili është i trajnuar për t'u marrë me zbulimet e dhunës ndaj grave, referojeni pacienten tuaj tek ai.




Sigurohuni që jeni në dijeni të **SHËRBIMEVE TË SPECIALIZUARA** për gratë e mbijetuara të dhunës pranë jush dhe informoni të mbijetuarat për këto shërbime, si strehëzat e grave, qendrat e grave dhe qendrat e sulmeve seksuale, në mënyrë që të mund të referoni pacienten tuaj (shërbimet e specializuara të grave janë më të pajisurat për të mbështetur gratë e mbijetuara pasi ato ofrojnë ndihmë të specializuar dhe të drejtpërdrejtë nëpërmjet një qasjeje të përqendruar tek të mbijetuarat).

Ofroni çdo shërbim të specializuar me të gjithë **INFORMACIONIN** që keni në dispozicion në lidhje me situatën e pacientes tuaj dhe regjistroni të gjitha referimet që bëni.



LGBTQ+



Nëse pacientja juaj vjen nga një **GRUP I MARGJINALIZUAR** (grua migrante, LGBTQ+, që jeton me aftësi të kufizuara) sigurohuni që të kontrolloni nëse ka shërbime të specializuara të krijuara për të mbështetur grupe të veçanta grash.

Bëjini të qarta opsionet e disponueshme për pacienten tuaj, por mos e shtyni atë të kërkojë një shërbim specifik. Nëse nuk ka shërbime lokale të disponueshme, mund t'i jepni pacientes tuaj kontaktin për **LINJAT KOMBËTARE TË NDIHMËS** për dhunën në familje.



UDHËZIME PËR OFRUESIT E KUJDESIT SHËNDETËSOR

si reagim ndaj rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

Lista kontrolli për praktikën tuaj për të mbështetur efektivisht gratë e mbijetuara të dhunës

- Burimet e edukimit dhe trajnimit** janë vënë në dispozicion të ofruesve të kujdesit shëndetësor në praktikë, për të mësuar se si të mbështesin më mirë të mbijetuarat e dhunës ndaj grave.
- Nëse është e mundur, **një avokat ose koordinator** është i disponueshëm në klinikën tuaj, i cili do të jetë përgjegjës për referimin e pacientëve që zbulojnë dhunën ndaj grave.
- Një dhomë** në klinikë, ambulancë, qendër shëndetësore është e disponueshme për të folur privatisht me pacientët ose klientët (prapa perdeve nuk konsiderohet konfidenciale).
- Është krijuar **një rrugë e qartë referimi** për pacientët dhe/ose klientët drejt shërbimeve të tjera të specializuara që mbështesin gratë e mbijetuara të dhunës.
- Të gjithë anëtarët e stafit** e dinë se çfarë shërbimesh dhe mbështetjesh janë të disponueshme për ata që zbulojnë dhunën në familje në fushën tuaj të praktikës, si dhe çdo program të mundshëm për dhunuesit.
- Lidhjet me shërbimet e specializuara** për të mbijetuarat e dhunës ndaj grave janë krijuar në zonën tuaj lokale për të ofruar një përgjigje të integruar ndaj dhunës në familje, të tilla si kontrollet/konsultimet e rregullta, trajnimet brenda shtëpisë dhe procedurat formale të referimit.
- Ekziston një **politikë e brendshme** për anëtarët e stafit që dëshirojnë të zbulojnë dhunën ose abuzimin (duke pranuar se jo vetëm pacientët mund të jenë të mbijetuar të dhunës ndaj grave).
- Një **formular i standardizuar** (ose kartelë mjekësore) përdoret për të dokumentuar lëndimet e përjetuara nga e mbijetuara e dhunës, për t'u përdorur më vonë në proceset gjyqësore, i cili ofrohet pa pagesë (ju lutemi kontrolloni rregulloret ligjore në vendin tuaj).
- Praktikuesit inkurajohen të caktojnë **takime pasuese** me pacientët që zbulojnë dhunën në familje dhe abuzime të tjera, për të siguruar që të mbijetuarit të trajtohen siç duhet dhe të marrin mbështetjen e nevojshme.
- Nëse është e mundur, **të dhënat** për zbulimin e pacientet mblidhen dhe vihen në dispozicion të shërbimeve të specializuara mbështetëse të grave për t'u përdorur për qëllime monitorimi, raportimi dhe avokimi.
- Në dhomat e pritjes dhe tualetet e grave vihen në dispozicion **postera dhe/ose fletëpalosje** me informacion mbi shërbimet e specializuara lokale për gratë e mbijetuara, dhe duke i inkurajuar pacientet të flasin me një anëtar të stafit nëse ndihen të pasigurta.
- Informacioni për abuzimin në familje dhe shërbimet e specializuara lokale shfaqen në **faqen e internetit** të ambulancës, klinikës, qendrës shëndetësore dhe në çdo buletin që qarkullon mes pacientëve.